



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 97, Datë 09.05.2022

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “KARAVASTA SOLAR” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME VENDNDODHJE NË ZONËN E REMASIT - KARAVASTA, LUSHNJE DHE LIBOFSHË, FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 140 MWP

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a”, nenit 13 dhe nenit 14, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.05.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 608/6 prot., datë 06.05.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën e Remasit - Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 MWp”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 261, datë 21.12.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me vendndodhje në zonën e Remasit – Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 MW.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE me shkresën nr. 6/29 prot., datë 22.12.2021, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (datë 04.02.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.
- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 49, datë 23.03.2022, u vendos zgjatja me 30 (tridhjetë) ditë pune e afatit të vendimmarrjes së bordit mbi aplikimin e shoqërisë për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i dhënë kështu mundësinë shoqërisë që të plotësojë dhe dokumentacionin e mbetur ende pa u plotësuar i cili duhet të depozitohet nga ana e saj në ERE, brenda 20 (njëzet) ditëve pune.

- Brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 49/2022, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. rezulton se shoqëria ka plotësuar kërkesat e Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, e ndryshuar, si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” “f” dhe “g”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni teknik për centralin fotovoltaik - neni 9, pikat 4.4.1; 4.4.2; 4.4.3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; 4.4.4 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”. **Plotësuar.**
- Leje nga institucione të tjera - neni 9, pika 4.4.5, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar.**
- Në lidhje me konstatimin se zona kadastrale e cituar në Deklaratën Mjedisore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) nuk përputhet me zonën kadastrale të cituar, në dokumentacionin pronësor të depozituar nga ana e shoqërisë për qëllime të këtij aplikimi, rezulton se shoqëria i ka dërguar shkresë AKM-së, më datë 08.04.2022, ku i është kërkuar korrigjimi i të dhënave kadastrale të Deklaratës Mjedisore. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë depozitimi në ERE i përgjigjes së AKM-së, brenda datës 20.06.2022, duke marrë në konsideratë afatin prej 45 ditëve pune (duke filluar ky afat nga data e depozitimit të shkresës), brenda të cilit AKM shprehet në lidhje me aplikimet, dhe duke i lënë 5 ditë kohë shoqërisë për të depozituar këtë dokument në ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën e Remasit – Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 MWp, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria të depozitohet në ERE, brenda datës 20.06.2022, përgjigjen/qëndrimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në lidhje me informacionin kadastral të Deklaratës Mjedisore për zhvillimin e projektit të Karavastasë.
3. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me plotësimin/mosplotësimin e kushtit sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij vendimi.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI